

VENDIM
Nr. 230, datë 14.4.2021

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE ME SHKËMBIM NOTASH TË
MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR SHITESËN E
FINANCIMIT PËR PROJEKTIN E MODERNIZIMIT TË ASISTENCËS SOCIALE, TË
RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 53/2018**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash të marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për projektin e modernizimit të asistencës sociale, të ratifikuar me ligjin nr. 53/2018, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BORXHIT PUBLIK DHE BASHKËRENDIMIT
TË NDIHMËS SË HUAJ
DREJTORIA E BASHKËRENDIMIT DHE SIGURIMIT TË NDIHMËS SË HUAJ
SEKTORI I SIGURIMIT TË NDIHMËS SË HUAJ DHE MARRËVESHJEVE

Nr. 23784 Prot.

Tiranë, më 22. 12. 2020

Lënda: Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale
(Huaja nr. 8841-AL)

ZNJ. LINDA VAN GELDER
DREJTOR RAJONAL, BALLKANI PERËNDIMOR
RAJONI I EVROPËS DHE AZISË QENDRORE
ZYRËS SË BANKËS BOTËRORE
Bulevardi "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Nr. 34, Tiranë

E nderuar Znj. Drejtore,


I referohem marrëveshjes së Huasë të datës 5 qershor 2018 ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për Projektin e Modernizimit të Asistencës Sociale. Me qëllim finalizimin e suksesshëm të aktiviteteve të parashikuara për t'u financuar nga kjo marrëveshje dhe në përputhje me sa kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet kësaj shkrese ju përcjellim kërkesën e palës shqiptare si vijon:

- Shtyrjen e afatit të mbylljes deri më 31 dhjetor 2022, Skeduli 2, Seksioni III.B.4

Kjo letër së bashku me letrën tuaj të përgjigjes do të përbëjnë marrëveshjen ndryshuese, me shkëmbim letrash të marrëveshjes së huasë nënshkruar më 5 qershor 2018, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për Projektin e Modernizimit të Asistencës Sociale.

Ky ndryshim hyn në fuqi, pasi palët të njoftojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të brendshme.

Me respekt,

MINISTËR

Anila Denaj
